



Autoriteti Evropian i Punës

Landererova 12, 811 09
Bratislavë - Sllovaki
info@ela.europa.eu

www.ela.europa.eu



Mësoni më shumë në
Your Europe Portal

Autoriteti Evropian i Punës, 2022

As Autoriteti Evropian i Punës (AEP) apo ndonjë person tjetër që vepron në emër të AEP-së, nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit në këtë dokument.

Riprodhimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat të drejtat e autorit nuk i ka AEP-ja, duhet të kërkohet leje direkt nga zotëruesi i të drejtave të autorit.

Të drejtat e autorit për imazhet: © iStock.com/Hilch


Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2022

Print ISBN 978-92-9464-244-8 doi:10.2883/86603 HP-01-22-237-SQ-C

PDF ISBN 978-92-9464-217-2 doi:10.2883/02542 HP-01-22-237-SQ-N

Shoferët të njoftuar – njihuni me të drejtat dhe detyrimet tuaja

Rregullat e reja të
“njoftimit të shoferëve”
kanë qenë në zbatim që
prej 2 shkurtit 2022



Ju jeni një shofer i njoftuar

Nëse kryeni operacione transporti për një periudhë të kufizuar në një Shtet tjetër

Anëtar të BE-së nga ai ku është themeluar punëdhënësi juaj, dhe ju kryeni operacionet e mëposhtme, ju jeni një shofer i njoftuar.

- **Kabotazhi.** Punëdhënësi për të cilin ju punoni nuk është i themeluar në Shtetin Anëtar ku kryeni operacione të transportit kombëtar.
- **Tregtia e kryqëzuar.** Operacionet e transportit mes dy Shteteve Anëtare dhe një vendi jashtë BE-së, dhe punëdhënësi juaj nuk është i themeluar në ndonjë prej këtyre vendeve.
- **Udhëtim pa ngarkesë.** Një udhëtim që është kryer në lidhje me një kabotazh ose një operacion tregtie të kryqëzuar që është subjekt i rregullave të njoftimit.
- **Operacionet e kombinuara të transportit.** Nëse pjesa e parë ose e fundit e një operacioni të kombinuar të transportit është një tregti e kryqëzuar ose operacion kabotazhi, atëherë ju jeni një shofer i njoftuar vetëm kur kryeni pjesën e parë ose të fundit.

Në rastin e një kontrolli në rrugë, ju duhet të jeni në gjendje t'i paraqisni inspektorit:

- një kopje të deklarates së njoftimit (versioni elektronik ose në letër);
- prova të operacioneve të transportit, që zhvillohen në Shtetin Anëtar pritës (p.sh. një faturë dorëzimi); dhe
- regjistrimet e takografit.

Punëdhënësi juaj duhet të sigurohet që të keni këto dokumente të përditësuara në dispozicionin tuaj.

Çfarë page dhe kushtesh të tjera pune keni të drejtë të merrni?

Nëse në përgjithësi paga dhe kushtet e punës janë më të mira në vendin për të cilin jeni njoftuar sesa në vendin ku është themeluar



punëdhënësi juaj, atëherë ju keni të drejtën për një pagë me nivel më të lartë dhe kushte më të mira pune. Nëse niveli nuk është më i lartë, atëherë vlejnë rregullat e vendit të themelimit.

Ju nuk jeni një shofer i njoftuar

Nëse kryeni ndonjë nga operacionet e mëposhtme të transportit, ju nuk jeni një shofer i njoftuar.

- **Një operacion dypalësh.** Transportim nga Shteti Anëtar ku është themeluar punëdhënësi juaj në një vend tjetër (brenda ose jashtë BE-së) ose kthim nga një vend tjetër (brenda ose jashtë BE-së) te Shteti Anëtar ku është themeluar punëdhënësi juaj.
- **Aktivitete të kufizuara shitesë ngarkimi dhe/ose shkarkimi.** Në Shtetet Anëtare ose vendet jashtë BE-së ndërkohë që kryeni një operacion dypalësh.
- **Tranzit.** Hyrja në një Shtet Anëtar pa ngarkuar ose shkarkuar.
- **Udhëtim pa ngarkesë.** Nëse udhëtimi juaj kryhet në lidhje me operacion dypalësh
- **Operacionet e kombinuara të transportit.** Nëse pjesa e parë ose e fundit e një operacioni të kombinuar të transportit është një operacion dypalësh, atëherë ju nuk jeni një shofer i njoftuar vetëm kur kryeni pjesën e parë ose të fundit.

Çfarë page dhe kushtesh pune keni të drejtë të merrni?

Kur nuk jeni një shofer i njoftuar, vlejnë nivelet e pagës dhe kushtet e punës të Shtetit Anëtar ku është i themeluar punëdhënësi juaj.

